

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SHA FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime SHA Fier, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për periudhën 01.05.2013-31.12.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 38 datë 30.03.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1054/8 datë 31.03.2015, dërguar z. Salarjon Totaj, Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Fier, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. UK Fier nuk ka analizuar humbjet në mënyrë analitike, duke mos ndarë humbjet menaxheriale (ekonomike) që vijnë nga faturimi afrofe, humbje për shkak të faturimit jo të saktë dhe humbje (teknike) në linjat e transmetimit dhe në rrjetin shpërndarës, duke mos bërë të mundur njohjen e shkaqeve të këtyre humbjeve dhe marrjen e masave për reduktimin e tyre.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga UK Fier që humbjet të analizohen në mënyrë analitike, duke përcaktuar nga se rezultojnë, në mënyrë që të mund të njihen shkaqet e këtyre humbjeve dhe marrjen e masave për reduktimin e tyre.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. Nuk ka rregullore të shkruar për procedurat e rekrutimit në punë, nivelin e arsimimit të kërkuar për çdo vend pune, vlerësimin e performancës, trajnimin dhe motivimin e punonjësve, dosjet individuale të punonjësve të shoqërisë nuk ishin të plotësuara, si dhe nuk është zbatuar Vendimi i Asamblesë së Aksionerëve nr. 47 prot, datë 27.02.2013, për parandalimin e konfliktit të interesave.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të merren masa për hartimin e një rregulloreje mbi rekrutimet e reja, ku të jetë i përshtatur vendi i punës me arsimin përkatës dhe duke zbatuar në emërimin e tyre Ligjin nr. 9637, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe të merren masa për plotësimin e dosjeve individuale të punonjësve, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë

3. Delegimi i kompetencave të Administratorit me Urdhrin nr. 385 prot, datë 31.03.2014, dy nëndrejtorëve të shoqërisë, është i pakufizuar në kohë e kompetenca, si dhe njëri nga ish-drejtorët nuk është më në atë funksion.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të rishqyrtojë Urdhrin nr. 385 prot, datë 31.03.2014, pasi është i pakufizuar në kohë dhe në kompetenca, si dhe në rastet e delegimit të kompetencave, delegimi të jetë i kufizuar.

Menjëherë

4. Për periudhën 01.01.2014-31.10.2014, është tejkaluar struktura e miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 56 prot, datë 18.12.2013, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 6,481,718 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës të analizohet tejkalimi i strukturës organike në vlerën **6,481,718 lekë** për periudhën 01.01.2014-31.10.2014, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse.

Brenda datës 30.06.2015

5. Nga auditimi i strukturës dhe listë-pagesave të vitit 2014, rezultoi se nuk është zbatuar nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë Ekonomike, Vendimi i Asamblesë së Aksionerëve nr. 46 prot, datë 27.12.2013, pasi për 127 punonjës janë paguar paga nën minimalen 28,000 lekë/muaj të vendosur nga Asambleja.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për pagimin e diferencës së pagës së paguar sipas Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve nr. 46 prot, datë 27.12.2013, për vitin 2014 për 127 punonjësit sipas listës bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi.

Brenda datës 30.06.2015

6. Për periudhën Korrik 2013-Dhjetor 2014, është paguar më pak në vlerën 180,000 lekë Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu II, pika 5.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të rishqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës shpërblimi i Sekretarit të këshillit në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, si dhe të merren masa për pagimin e diferencës në vlerën 180,000 lekë.

Brenda datës 30.06.2015

7. Është paguar shpërblimi vjetor në vlerën 1,350,000 lekë për 270 persona me listë-pagesat e muajit Dhjetor 2013 dhe në vlerën 1,315,000 lekë për 263 persona me listë-pagesat e muajit Dhjetor 2014, para daljes së rezultatit financiar, vlera të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të UK Fier, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të rishqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës shpërblimi i paguar për punonjësit, në vlerën **1,350,000 lekë** për vitin 2013 dhe në vlerën **1,315,000 lekë** për vitin 2014, të paguar para daljes së rezultatit financiar vjetor në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Brenda datës 30.06.2015

8. Detyrimi i energjisë elektrike i paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të vitit 2013, është paraqitur 39,731,734.50 lekë më pak se detyrimi i njohur me rakordimin ndërmjet UK Fier dhe CEZ Shpërndarje Sha, si dhe nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2013, provizionet për detyrimet e kamatë-vonesave të energjisë elektrike në vlerën 287,276,332.66 lekë dhe pse këto detyrime janë njohur në rakordimin e nënshkruar midis palëve më datë 31.03.2014, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardi Kombëtar Kontabël “SKK 6 – Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për paraqitjen e saktë në pasqyrat financiare, të detyrimeve për energjinë elektrike, në zbatim të VKM nr. 198, datë 03.04.2014 “Për përcaktimin e shumave të shuarjes me kompensim të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore që financohen nga buxheti, Kesh Sh.a., CEZ Shpërndarje Sha dhe Ministrisë së Financave”.

Menjëherë

9. Drejtoria Ekonomike ka paraqitur në pasqyrat financiare, gjendjen debitoare më pak në vlerën 22,822,834.60 lekë për vitin 2013 dhe më pak në vlerën 18,540,011.13 lekë për vitin 2014, në krahasim me të dhënat e Drejtorisë së Shitjes.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shitjes, të merren masa për rakordimin e vlerës së debitorëve dhe paraqitjen e saktë të kësaj vlere në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2014.

Menjëherë

10. Në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14 prot, datë 28.10.2011, në listat e debitorëve të UK Fier rezultojnë punonjës të shoqërisë, si dhe janë vendosur në mënyrë selektive masa disiplinore për 15 punonjës, me arsyetimin e mos-pagimit të detyrimeve të ujit, pasi në datat e dhënies së masave disiplinore rezultojnë 30 punonjës të cilët ishin debitorë ndaj UK Fier.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Shitjes të merren masa për arkëtimin e detyrimeve që punonjësit e shoqërisë kanë për faturat e papaguara, si dhe të propozohen masat përkatëse në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14 prot, datë 28.10.2011.

Vazhdimisht

11. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011 “Për faturimet aforfe”, ka mangësi në lidhje me llojin e bizneseve, pasi në të nuk janë të përfshirë bizneset të cilat për nga natyra e tyre janë konsumuese të mëdha të ujit si punishtet, fabrikat, lavazho.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës të rishqyrtojë Vendimin nr. 37 prot, datë 16.12.2011, për faturimin afrofe, duke përfshirë në të gjithë llojet e bizneseve që furnizohen me ujë nga UK Fier.

Brenda datës 30.06.2015

12. Është faturuar sasia 430 m³ ujë me vlerë 53,750 lekë, për 33 biznese për të cilat ishte vënë shënimi “Mbyllur”, si dhe është faturuar sasia 17,381 m³ ujë me vlerë 2,121,445 lekë më tepër se norma e përcaktuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011, për mesatarisht 132 biznese në muaj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Shitjes të bëhen rregullimet e duhura për klientët të cilët kanë shënimin mbyllur dhe vazhdojnë të faturohen, si dhe për ata klientë të cilët faturohen më tepër se norma e përcaktuar në Vendimin nr. 37 prot, datë 16.12.2011, të Këshillit Mbikëqyrës.

Brenda datës 30.06.2015

13. Nga sondazhi i kryer në arkivën e shoqërisë u kërkuar gjithsej 14 shkresa me zgjedhje, në përfundim të të cilit nuk u gjetën 3 shkresa, nuk u gjet kopja origjinale e Urdhrit nr. 385 prot, datë 31.03.2014 “Për delegimin e kompetencave të administratorit”, si dhe nuk u gjet shtesa e kontratës nr. 174/4, datë 12.02.2014 e lidhur me shoqërinë....., në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për funksionimin e arkivës në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 26.01.2003 “Për arkivat”.

Brenda datës 30.06.2015

14. Në 2 raste nuk janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 42-50.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i shoqërisë, të merren masa për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

15. Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, nuk janë dhënë detaje teknike të plota, nuk është argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve, për grup mallrat e ngjashme është tejkaluar limiti ligjor prej 400.000 lekë, si dhe nuk është hartuar dhe dërguar në APP regjistri i realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën e një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure, si dhe të marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP të regjistrit të realizimit dhe parashikimit për këto procedura.

Vazhdimisht

16. Drejtoria e Shoqërisë nuk ka kryer analizë të hollësishme mbi gjendjen e debitorëve nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykitimit ndaj subjekteve debitoare nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshillit Mbikëqyrës

-Ka mangësi në procesin e faturimit aforfe.

-Në 36 raste u konstatua se të dhënat e faturimit ndryshonin me të dhënat e matësit.

-Ka mangësi në procesin e kontrollit mbi procesin e faturimit, nga ana e përgjegjësit të faturimit dhe drejtorit të drejtorisë së shitjes.

-Nuk ka transparencë në procesin e faturimit aforfe, çka ka rezultuar në faturime të ndryshme për situata të njëjta.

-Ka mungesë transparence dhe kontrolli në procesin e përzgjedhjes dhe ndjekjes, të debitorëve të dërguar për shpallje titulli ekzekutiv të faturave të ujit të papaguara.

-Debia totale ndaj UK Fier, për faturat e ujit të papaguara, ka ardhur në rritje në vitin 2013 dhe 2014.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të analizojnë gjendjen debitoare dhe kreditore për reduktimin e tyre, si dhe të marrin masa për sigurimin e transparencës dhe kontrollit në procesin e faturimit aforfe dhe proceset e përzgjedhjes dhe ndjekjes së debitorëve që dërgohen për shpallje titulli ekzekutiv të faturave të ujit të papaguara.

Brenda datës 30.06.2015

17. UK Fier nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet), si dhe të gjitha objektet që në kontabilitet janë regjistruar në zërin “Troje” nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33, si dhe Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masat për krijimin e regjistrit kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, kryerjen e inventarizimeve të plota vjetore me qëllim evidentimin e saktë të aktiveve, si dhe regjistrimin e objekteve të cilat në kontabilitet janë pasqyruar në “Zërin troje”, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Brenda datës 30.06.2015

18. Komisionet për vlerësimin e normativave të harxhimit të karburantit për secilin mjet janë ngritur nga drejtori teknik i shoqërisë, në tejkalim të kompetencave ligjore, në kartelat mujore nuk përshkruhej arsyeja e lëvizjes së mjetit dhe nuk u gjendën Urdhër-Shërbimet apo Urdhër e Punës së Administratorit, si dhe për 5 automjete rezultuan diferenca kilometrat e përshkruara ndërmjet të dhënave të sistemit GPS dhe kartelave mujore.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i shoqërisë, të ngrihen komisionet për matjen e konsumit të karburantit nga mjetet e UK Fier e të nxirren urdhrat për administrimin dhe përdorimin e tij, si dhe të merren masa për rakordimin e kartelave mujore me të dhënat e sistemit GPS, sipas kërkesave ligjore të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 30.06.2015

19. UK Fier nuk ka hartuar plane emergjence, nuk ka përfshirë në ndryshimet në rregulloren e brendshme implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe treguesit e performancës, nuk ka marrë masa për ngritjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit, si dhe 2 auditues nuk janë të pajisur me Dëshminë e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të rishikohet rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të shoqërisë, të bëhen rregullimet e nevojshme ku të jenë të implementuara sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, të merren masa për hartimin e planeve të emergjencës, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 20, si dhe të merren masa për përcaktimin e njësisë së auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Brenda datës 30.06.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nuk është zbatuar masa e zhdëmtimit nr. 1, ku KLSH ka rekomanduar “Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe përmbarimore dhe të gjitha shkallët e gjykimit nëse nevojitet, për arkëtimin në vlerën **4,640,429 lekë**”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe përmbarimore dhe të gjitha shkallët e gjykimit nëse nevojitet, për arkëtimin në vlerën **4,640,429 lekë** për përfitim të padrejtë nga: shoqërianë vlerën 3.637.229 lekë; nga shoqëria në vlerën 763,200 lekë; si dhe nga shoqëria në vlerën 240,000 lekë.

Menjëherë

2. Janë paguar për periudhën 01.09.2014-30.11.2014, në vlerën 319,545 lekë anëtarët e këshillit mbikëqyrës pasi ju ka mbaruar mandati (31.08.2014), në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 155, pika 2.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **319,545 lekë**, nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, si përfitim i padrejtë i shpërblimit pasi u ka mbaruar mandati, konkretisht nga: në vlerën 106,515 lekë, në vlerën 71,010 lekë,në vlerën 71,010 lekë dhe në vlerën 71,010 lekë.

Menjëherë

3. Është paguar ish-anëtari i këshillit mbikëqyrës....., për periudhën 01.10.2013-31.11.2014, në vlerën **331,380 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar, neni 5.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **331,380 lekë** nga ish-anëtari i Këshillit Mbikëqyrës....., si shpërblim i përfituar në mënyrë të padrejtë në kundërshtim me

Ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin” dhe Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”.

Menjëherë

4. Për periudhën 01.10.2014-31.12.2014, shoqëria është faturuar me çmimin e institucionit buxhetor dhe jo me çmimin e entit privat, duke rezultuar në një dëm ekonomik në vlerën **4,400 lekë**, në kundërshtim me kontratën nr. 422 prot, datë 07.05.2014 “Për aplikimin e tarifave të ujit”, lidhur ndërmjet Administratorit të UK Fier dhe Kryetarit të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **4,400 lekë**, nga shoqëria....., për faturimin me çmimin e gabuar.

Menjëherë

5. Është faturuar aforfe sasia 36,341 m³ ujë me vlerë **4,427,850 lekë** më pak se norma e përcaktuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011, për mesatarisht 138 biznese në muaj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **4,427,850 lekë**, nga bizneset e faturuara në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011.

Menjëherë

6. Ujësjiellës Kanalizime Fier Sha nuk ka llogaritur kamat-vonesa ndaj operatorit ekonomik në vlerën **66,640 lekë**, për vonesë në ekzekutimin e kontratës nr. 690, datë 17.10.2013.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **66,640 lekë** nga operatori ekonomik....., për vonesë në ekzekutimin e kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Menjëherë

7. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të administruar në dosjen teknike, si dhe kontrolli fizik në objekt i zbatimit të kontratës “Ndërtim Ujësjiellësi Pusi 8B”, u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria [REDAKTUAR], dhe shkaktuar një dëm ekonomik për Ujësjiellës Kanalizime Fier në vlerën **1,212,460.80 lekë**.

-Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të administruar në dosjen teknike, si dhe kontrolli fizik në objekt i zbatimit të kontratës “Shpim Pusi Peshtan të UK Fier”, u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria dhe shkaktuar një dëm ekonomik për Ujësjiellës Kanalizimeve Fier, në vlerën prej **25,464.0 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **1,237,924.80 lekë** nga operatori ekonomik, konkretisht; vlera 1,212,460.80 lekë si përfitim i padrejtë në zbatimin e kontratës “Ndërtim Pusi 8/B” dhe vlera 25,464.0 lekë si përfitim i padrejtë në zbatimin e kontratës “Ndërtim Pusi Peshtan”.

Menjëherë

8. Në 49 raste u konstatuan diferenca të çmimeve të mallrave të prokuruar për të njëjtin mall në kohë të ndryshme, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 84,546.62 lekë** për shoqërinë UK Fier.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **84,546.62 lekë** nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për diferencat e konstatuara në çmimet e mallrave të prokuruar.

Menjëherë

9. Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël “Blerje Fotokopje Multifuction”, është s`kualifikuar pa argumentimin e duhur ligjor operatori ekonomik i renditur në vendin e parë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **45,600 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **45,600 lekë** nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për s`kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik të renditur i pari në procedurën me blerje me vlerë të vogël.

Menjëherë

10. Nga auditimi i zbatimit të procedurës “Blerje GPS për menaxhimin e mjeteve”, rezultoi se nga 9 GPS të prokuruar, 2 GPS nuk ishin instaluar dhe 7 GPS e tjerë janë instaluar 3 muaj e vonesë duke mos llogaritur penalitete për vonesën dhe mosrealizimin e kontratës, në kundërshtim me kontratën nr. 308 prot, datë 04.04.2014, neni 5, si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 42 dhe 54.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **145,067 lekë** nga operatori ekonomik, konkretisht 34,667 lekë për pagesën e 2 GPS të pa instaluar dhe 110,400 lekë penalitete në zbatim të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.

Menjëherë

11. Nga verifikimi i të dhënave të sistemi GPS, me të dhënat e kartelave, për 5 automjete të UK Fier, rezultoi se sipas kartelave në total për periudhën Korrik-Dhjetor 2014, kanë përshkruar 35,196 km, ndërsa sipas sistemi GPS konstatoheshin vetëm 17,539 km, duke shënuar më tepër në kartela 17,657 km, duke shkaktuar një dëm ekonomik **në vlerën 265,913.71 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **265,913.71 lekë**, nga drejtuesit e mjeteve të UK Fier, për naftën e konsumuar për kilometrat e shënuara më tepër në kartelat mujore, konkretisht nga:, në vlerën 87,832.03 leke,në vlerën 10,714.25 lekë,, në vlerën 35,252.93 lekë, në vlerën 99,988.99 lekë dhe në vlerën 32,125.52 lekë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenet 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në Kontratën Kolektive të punës nr. 566, datë 26.07.2013, dhënien e masës disiplinore:

Neni 15, pika 3, gërma b “Vërejtje me paralajmërim”

1....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike

-Në 3 raste nuk ka nënshkruar ofertën ekonomike.

-Në 1 rast për kualifikim të operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion.

-Në 1 rast për hartimin e specifikimeve teknike me mangësi si anëtar i njësisë së prokurimit.

- Në 1 rast për mos mbajtje të një raporti përmbledhës për Titullarin si anëtar i grupit të kolaudit.
- Për mos-paraqitje të saktë të procesit të inventarizimit në sektorin Kafaraj.
- Në një rast ka bërë kërkesë për blerje me vlerë të vogël, për mallra të cilat duhet të ishin parashikuar në preventivin e procedurës “Ndërtim linja ujësjellësi pusi 8B”, si pjesë integrale e kësaj procedure.
- Ka ngritur grupin e punës për përcaktimin e normativave të harxhimit të karburantit, në tejkalim të kompetencave ligjore.
- Për miratimin e kryerjes së harxhimit të karburanti, pa urdhër-shërbimet apo urdhrat e punës së Administratorit.
- Për mos-zbatimin e urdhrit të administratorit dhe mos-pasqyrimin e saktë të situatës dhe dëmeve të shkaktuara nga përmbytja.
- Sasia e ujit të prodhuar që është pasqyruar në evidencat zyrtare nuk pasqyron gjendjen reale të ujit që prodhohet, për shkak të metodës së gabuar që përdoret për matjen e prodhimit.
- Nuk ka marrë masa për kalibrimin e matësive.
- Për mos zbatimin e urdhrit të administratorit për ndjekjen e kontratës nr. 777, datë 27.11.2013, me objekt “Ndërtim linja ujësjellësi pusi 8B”, duke i shkaktuar shoqërisë dëm ekonomik në vlerën 1,212,460.80 lekë.

2....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prodhimit

- Për mos-zbatimin e Urdhrit të Administratorit nr. 421 prot, datë 04.04.2014, për kolaudimin e GPS, duke rezultuar në një dëm ekonomik në vlerën 110,400 lekë.
- Për mos-paraqitje të saktë të procesit të inventarizimit në sektorin Kafaraj.
- Sasia e ujit të prodhuar që është pasqyruar në evidencat zyrtare nuk pasqyron gjendjen reale të ujit që prodhohet, për shkak të metodës së gabuar që përdoret për matjen e prodhimit.
- Nuk ka marrë masa për kalibrimin e matësive.
- Në 1 rast për mos argumentim të nevojës ekstreme për ndjekjen e procedurës.
- Në 1 rast për mos përshkrim të saktë të mallrave të kolauduar duke e bërë të pa mundur verifikimin e tyre në terren.
- Në 1 rast për mos mbajtje të një raporti përmbledhës për Titullarin si anëtar i grupit të kolaudit.
- Në 1 rast për kualifikim të operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion.
- Në një rast ka bërë kërkesë për mallra, të cilat duhet të ishin parashikuar në preventivin e procedurës “Ndërtim linja ujësjellësi pusi 8B”, si pjesë integrale e kësaj procedure.
- Për miratimin e kryerjes së harxhimit të karburanti, pa urdhër-shërbimet apo urdhrat e punës së Administratorit.
- Për mos zbatimin e urdhrit të administratorit për ndjekjen e kontratës nr. 777, datë 27.11.2013, me objekt “Ndërtim linja ujësjellësi pusi 8B”, duke i shkaktuar shoqërisë dëm ekonomik në vlerën 1,212,460.80 lekë.

3....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore

- Nuk ka marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimit i mëparshëm i KLSH.
- Është në konflikt interesi (baba-bijë) me një anëtar të këshillit mbikëqyrës.
- Për mangësitë e rezultuara në dosjet individuale të punonjësve të shoqërisë.
- Për mos komunikimin e masës disiplinore për personat që nuk paraqiten në punë, në kundërshtim me Kontratën Kolektive nr. 566 prot, datë 26.07.2013, neni 15/2, pika 6.
- Drejtori i Burimeve Njerëzore nuk është i arsimuar në profilin përkatës
- Për mangësitë e konstatuara në Rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 70/1 prot, datë 08.07.2014.
- Për tejkalimin e strukturës organike në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 70/1 prot, datë 08.07.2014, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 6,481,718 lekë.

-Nuk ka marrë masa për zbatimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve nr. 46 prot, datë 27.12.2013, pasi për 127 punonjës janë paguar paga nën minimalen e vendosur nga Asambleja 28,000 lekë/muaj për vitin 2014.

-Në 1 rast për mos argumentim të saktë për ndjekjen e procedurës së prokurimit.

4....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shitjes

-Nuk ka marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimit i mëparshëm i KLSH.

-Nuk ka marrë masa për kryerjen e kontrollit të vlerës së faturuar nga faturuesit, në kundërshtim me Rregulloren e funksionimit të Shoqërisë, duke rezultuar në parregullsi në faturim.

-Nuk ka transparencë në procesin e faturimit aforfe, çka ka rezultuar në faturime të ndryshme për situata të njëjta.

-Për mangësitë e konstatuara në procesin e faturimit, si dhe për mos-zbatimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011, për faturimet aforfe.

-Për mos-rakordimin e gjendjes debitore të viteve 2013 dhe 2014, me drejtorinë ekonomike.

-Për mos-përfundimin në kohë të procesit të inventarizimit të vitit 2014, në kundërshtim me Planin e Masave nr. 1135 prot, datë 01.12.2014, të miratuar nga Administratori.

-Për mos-paraqitjen e diferencave të konstatuara midis gjendjes kontabile dhe gjendjes fizike për vitin 2014.

-Për miratimin e kryerjes së harxhimit të karburanti, pa urdhër-shërbimet apo urdhrat e punës së Administratorit.

-Për mos marrjen e masave për pasqyrimin e gjendjes reale të ujit që faturohet, për shkak të nivelit të lartë të sasisë së faturuar aforfe dhe shkeljeve të konstatuara në këto faturime.

Neni 15, pika 3, gërma a “Vërejtje me shkrim”

1....., me detyrë nën/Drejtor i Përgjithshëm

-Në 1 rast për kualifikim të operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion.

-Për mos-përfundimin në kohë të procesit të inventarizimit të vitit 2014, në kundërshtim me Planin e Masave nr. 1135 prot, datë 01.12.2014, të miratuar nga Administratori.

-Për mos-paraqitjen e diferencave të konstatuara midis gjendjes kontabile dhe gjendjes fizike për vitin 2014.

-Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP, të regjistrit të realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

-Për mos-zbatimin e Urdhrit të Administratorit nr. 421 prot, datë 04.04.2014, për kolaudimin e GPS, duke rezultuar në një dëm ekonomik në vlerën 110,400 lekë.

-Për mos-zbatimin e urdhrit të administratorit dhe mos-pasqyrimin e saktë të situatës dhe dëmeve të shkaktuara nga përmbytja.

2....., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

-Ka paguar ish-anëtarin e këshillit mbikëqyrës z., për periudhën 01.10.2013-31.11.2014, në vlerën 331,380 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar, neni 5.

-Nuk ka marrë masa për zbatimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve nr. 46 prot, datë 27.12.2013, pasi për 127 punonjës janë paguar paga nën minimalen e vendosur nga Asambleja 28,000 lekë/muaj për vitin 2014.

-Nuk ka marrë masa për paraqitjen në kohë të pasqyrave financiare të vitit 2013.

-Nuk ka marrë masa për paraqitjen e saktë të detyrimeve të energjisë elektrike dhe kamat-vonesave në pasqyrat financiare.

-Ka paraqitur në PF gjendjen debitore më pak në vlerën 18,540,011.13 lekë.

-Nuk ka marrë masa për hartimin e regjistrit kontabël të përditësuar të aktiveve që UK Fier zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet).

-Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP, të regjistrit të realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

-Ka paguar faturën tatimore nr. 580, datë 03.04.2014, me vlerë 156,000 lekë, pa u kryer më parë shërbimi.

-Ka kryer pagesa nga arka mbi limitin 1,000 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 64.

-Në 2 raste për mos protokollim të dokumenteve të tenderit si anëtar i njësisë së prokurimit.

3....., me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Faturimit

-Nuk ka marrë masa për kryerjen e kontrollit të vlerës së faturuar nga faturuesit, në kundërshtim me Rregulloren e funksionimit të Shoqërisë, duke rezultuar në parregullsi në faturim.

-Për mangësitë e konstatuara në procesin e faturimit, si dhe për mos-zbatimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 37 prot, datë 16.12.2011, për faturimet aforfe.

-Nuk ka transparencë në procesin e faturimit aforfe, çka ka rezultuar në faturime të ndryshme për situata të njëjta.

4....., me detyrë Faturiste

-Për faturimin 37 klientëve në kundërshtim me matësin.

5....., me detyrë Financier

-Për mos-përfundimin në kohë të procesit të inventarizimit të vitit 2014, në kundërshtim me Planin e Masave nr. 1135 prot, datë 01.12.2014, të miratuar nga Administratori.

-Për mos-paraqitjen e diferencave të konstatuara midis gjendjes kontabile dhe gjendjes fizike për vitin 2014.

-Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP, të regjistrit të realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, pa u hartuar më parë kërkesat vjetore për mallra nga drejtoritë e UK Fier.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, si dhe nuk janë dhënë detaje teknike të plota.

-Blerjet me vlera të vogla, janë kryer pa u argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

-Në 49 raste u konstatuan diferenca të çmimeve të mallrave të prokuruar për të njëjtin mall në kohë të ndryshme, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 84,546.62 lekë për shoqërinë UK Fier.

-Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël "Blerje Fotokopje Multifuction", është s`kualifikuar pa argumentimin e duhur ligjor operatori ekonomik i renditur në vendin e parë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 45,600 lekë.

-Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 400.000 lekë. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

6., me detyrë Inxhinier Bilanci

-Për mos-përfundimin në kohë të procesit të inventarizimit të vitit 2014, në kundërshtim me Planin e Masave nr. 1135 prot, datë 01.12.2014, të miratuar nga Administratori.

-Për mos-paraqitjen e diferencave të konstatuara midis gjendjes kontabile dhe gjendjes fizike për vitin 2014.

-Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP, të regjistrit të realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

-Për mos-zbatimimin e urdhrit të administratorit dhe mos-pasqyrimin e saktë të situatës dhe dëmeve të shkaktuara nga përmbytja.

7., me detyrë Inxhinier Elektro Mekanik

-Në 2 raste për mos mbajtje të një raporti përmbledhës për Titullarin si anëtar i grupit të kolaudit.

-Në 1 rast për mos përshkrim të saktë të mallrave të kolauduar duke e bërë të pa mundur verifikimin e tyre në terren.

-Në 3 raste nuk ka nënshkruar ofertën ekonomike.

-Për mos-paraqitje të saktë të procesit të inventarizimit në sektorin Kafaraj.

-Për mos-zbatimimin e urdhrit të administratorit dhe mos-pasqyrimin e saktë të situatës dhe dëmeve të shkaktuara nga përmbytja.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, pa u hartuar më parë kërkesat vjetore për mallra nga drejtoritë e UK Fier.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, si dhe nuk janë dhënë detaje teknike të plota.

-Blerjet me vlera të vogla, janë kryer pa u argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

-Në 49 raste u konstatuan diferenca të çmimeve të mallrave të prokuruar për të njëjtin mall në kohë të ndryshme, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 84,546.62 lekë për shoqërinë UK Fier.

-Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël “Blerje Fotokopje Multifuction”, është s`kualifikuar pa argumentimin e duhur ligjor operatori ekonomik i renditur në vendin e parë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 45,600 lekë.

-Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 400.000 lekë. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

8., me detyrë specialist i vulosjeve pranë drejtorisë së shitjes

-Ka firmosur urdhër-prokurimin dhe kontratën për procedurën me blerje me vlerë të vogël “Blerje e 9 GPS”, pa patur më parë autorizimin përkatës.

-Për mos-ndjekjen e zbatimit të procedurës “Blerje e 9 GPS”, duke rezultuar në një dëm ekonomik në vlerën 110,400 lekë.

-Në 1 rast për kualifikim të operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion.

9., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Elektro-Mekanik

-Në 1 rast për mos argumentim të saktë për ndjekjen e procedurës së prokurimit.

-Në 1 rast për mos mbajtje të një raporti përmbledhës për titullarin si anëtar i grupit të Kolaudit të tenderit me objekt “Blerje Automjeti”

-Në 1 rast për mos përshkrim të saktë të mallrave të marrë të kolauduar si anëtar i grupit të kolaudit.

-Për mos-mbajtjen e kartelave mujore të konsumimit të karburantit në përputhje me ligjin, si dhe mos-rakordimin e tyre me sistemin GPS duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 265,913.71 lekë.

-Për mos-paraqitje të saktë të procesit të inventarizimit në sektorin Kafaraj.

-Për mos-zbatimimin e urdhrit të administratorit dhe mos-pasqyrimin e saktë të situatës dhe dëmeve të shkaktuara nga përmbytja.

10., me detyrë punonjës pranë Dispeçerisë

-Për mos-zbatimimin e Urdhrit të Administratorit nr. 421 prot, datë 04.04.2014, për kolaudimin e GPS, duke rezultuar në një dëm ekonomik në vlerën 110,400 lekë.

-Për mos-kryerje të kolaudit të mallit të prokuruar.

11., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike

- Në 1 rast për mos paraqitje në librin e parashikimeve të prokurimeve të tenderit me objekt “Blerje Automjeti” viti 2013 si anëtar i njësisë së prokurimit.
- Në 6 raste për mos protokollim të dokumenteve të tenderit si anëtar i njësisë së prokurimit.
- Në 1 rast për mos mbajtje të një raporti përmbledhës për argumentimin e anulimit të tenderit me objekt “Punime në pusin 8B”.
- Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP, të regjistrimit të realizimit dhe parashikimit për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

12., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prodhimit Kafaraj

- Për mos-mbajtjen e kartelave mujore të konsumimit të karburantit në përputhje me ligjin, si dhe mos-rakordimin e tyre me sistemin GPS duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 265,913.71 lekë.

13., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes, Eliminimit të avarive dhe Humbjeve në Linjat e Transmetimit

- Për mos-mbajtjen e kartelave mujore të konsumimit të karburantit në përputhje me ligjin, si dhe mos-rakordimin e tyre me sistemin GPS duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 265,913.71 lekë.

14., me detyrë Juriste

- Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, pa u hartuar më parë kërkesat vjetore për mallra nga drejtoritë e UK Fier.
- Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u bërë, specifikimi i saktë i mallrave dhe i materialeve që janë prokuruar, si dhe nuk janë dhënë detaje teknike të plota.
- Blerjet me vlera të vogla, janë kryer pa u argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve.
- Në 49 raste u konstatuan diferenca të çmimeve të mallrave të prokuruar për të njëjtin mall në kohë të ndryshme, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 84,546.62 lekë për shoqërinë UK Fier.
- Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël “Blerje Fotokopje Multifuction”, është s`kualifikuar pa argumentimin e duhur ligjor operatori ekonomik i renditur në vendin e parë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 45,600 lekë.
- Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 400.000 lekë. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit, Alfonc Gabili, Keida Muça dhe Altin Tafilaj, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, si dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj.